



# **BULETINI I OEMVP**

**KORRIK –  
SHTATOR  
2025**



Str. Dimitrie Cupovski 13  
1000 Skopje, Macedonia  
Tel. +389 (0)2 3239 252  
[oemvp.org](http://oemvp.org)

[www.oemvp.org](http://www.oemvp.org)

## Përmbajtja

Përmbajtja.....	1
Hyrje .....	3
1. Sundim i ligjit, institucione efektive me përgjegjësi fiskale dhe financiare si nevojë thelbësore për ekonomi të fuqishme të tregut të lirë.....	4
1.1 Takim mes Kryesisë së OEMVP dhe Kryetarit të Kuvendit z.Afrim Gashi: Në fokus korniza ligjore e qëndrueshme, përfshirja aktive e biznesit dhe dialogu institucional.....	4
1.2 Takim i OEMVP me Komisionin për mbrojtjen e konkurrencës - Forcimi i mekanizmave për konkurrencë të ndershme.....	4
1.3 OEMVP në takim me Bankën Popullore - Guvernatori mirëpret propozimet e OEMVP-së për përmirësimin e kushteve financiare .....	5
2. Fuqi punëtore të mjaftueshme dhe të kualifikuar me një ekonomi diverze dhe zhvillimore që parandalon emigrimin.....	6
2.1 Një falënderim për më shumë se 100 kompani nga Struga dhe rrethina për praninë në këtë ngjarje! .....	6
4. Odë me kredibilitet dhe përfshirje lokale dhe rajonale, lidere në mbrojtje të interesave afariste .....	7
4.1 OEMVP mirëpret Ambasadoren e Japonisë në Shkup, Shkëlqesinë e Saj znj.Kawahara Setsuko – u diskutua thellimi i bashkëpunimit ekonomik me Japoninë.....	7
4.2 OEMVP zhvillon takim me kryesinë e Aleanca Kosovare e Bizneseve.....	7
4.3 Hapja solemne e Ĕmbla Hotel & Spa në zemër të Strugës – një tjetër sukses i kompanisë Trim&Lum .....	8
4.4 Kryetari Mendi Qyra deponon dorëheqjen, emërohet Ushtruesi i Detyrës së Kryetarit z. Nuhi Aliu. Mbahet mbledhja e IV-të e Këshillit Drejtues të OEMVP! .....	8
4.5 OEMVP takohet me Odën e Industrisë së Konja-s. Diskutohen mundësi bashkëpunimi për kompanitë anëtare të të dyja palëve .....	9
4.6 Takim me Ministrin e Bujqësisë z. Tripunovski - OEMVP apelon për strategji afatgjatë në mbrojtjen e prodhimeve vendore .....	9
4.7 OEMVP mirëpret delegacion biznesi nga Turqia për mundësi të reja bashkëpunimi .....	10
4.8 Takim mes U.D Kryetarit të OEMVP, z. Nuhi Aliu, dhe Kryetarit të OEMV, z. Branko Azeski .....	10
4.9 Mbahet mbledhja e V-të e Këshillit Drejtues të OEMVP. Diskutohen prioritetet për zhvillim ekonomik lokal. ....	11
4.10 OEMVP ndërmjetëson bashkëpunim të ri mes kompanive vendore dhe bizneseve turke të sektorit të ndërtimtarisë.....	11
4.11 Neho Ice Cream, anëtari më i ri i Odës Ekonomike të Maqedonisë Veri-Perëndimore .....	12

4.12 OEMVP realizon takim konsultativ në Ministrinë e Energjisë, minierave dhe lëndëve të para. Diskutohen zhvillimet e sektorit energjetik dhe problemet e biznesit me të njëjtën .....	12
4.13 OEMVP zhvillon takim informativ me Ministrinë e mjedisit jetësor rreth Projektit rajonal për menaxhimin e mbeturinave në Pollog .....	13
4.14 Takim pune me Odën Ekonomike të Dubait, OEMVP prezanton mundësitë e bashkëpunimit në kuadër të anëtarësisë së saj .....	13
Informatori ekonomik ECONOMICUS .....	14
Biznes Informatori DOBIA .....	15
5. Zvogëlimi i ekonomisë gri (joformale), minimizimi i korrupsionit dhe konkurrencës jo lojale si parakusht i konkurrueshmërisë së shëndoshë ekonomike .....	16
5.1 REAGIM .....	16
6. Marrëdhëniet me publikun .....	17
7. Komunikimi me anëtarët .....	18
8. OEMVP në media .....	18
9. OEMVP në rrjetet sociale .....	19
Shërbimet e OEMVP .....	20

## Hyrje

Buletini i OEMVP është dokument i cili publikohet në baza kuartale dhe i cili përmban përshkrim të shkurtuar të aktiviteteve të OEMVP-së për periudhën e raportimit. Në kuartalin e tretë gjegjësisht periudhën Korrik – Shtator 2025, OEMVP me qëllim të realizimit të vizionit, misionit dhe qëllimeve strategjike afatgjate të OEMVP-së ka organizuar aktivitete të ndryshme duke vazhduar të etablohet si një institucion i mirëfilltë dhe profesional i drejtuar në përkrahjen dhe avancimin e bizneseve në vend dhe më gjerë.

Strategjia e OEMVP-së për vitin 2024 – 2027 është e bazuar mbi kontekstin e përgjithshëm, nevojat prioritare, aktivitetet e aktorëve tjerë si dhe mbi rolin e vet, dhe ka të definuara pesë objektiva strategjike. Bazuar në vizionin dhe misionin, po ashtu edhe në qëllimet afatgjate të Odës, gjatë kësaj periudhe jemi angazhuar në arritjen e këtyre qëllimeve strategjike:

1. Sundim i ligjit, institucione efektive me përgjegjësi fiskale dhe financiare si nevojë thelbësore për ekonomi të fuqishme të tregut të lirë.
2. Fuqi punëtore të mjaftueshme dhe të kualifikuar me një ekonomi diverze dhe zhvillimore që parandalon emigrimin.
3. Shtet Evropian, anëtare e BE-së, me institucione dhe biznese moderne të digjitalizuara dhe të drejtuara drejt ekonomisë cirkulare dhe burimeve të ripërtrishme të energjisë.
4. Odë me kredibilitet dhe përfshirje lokale dhe rajonale, lidere në mbrojtje të interesave afariste.
5. Zvogëlimi i ekonomisë gri (joformale), minimizimi i korrupsionit dhe konkurrencës jo lojale si parakusht i konkurrueshmërisë së shëndoshë ekonomike.

**Durim Zekiri**

Drejtor Ekzekutiv

## 1. Sundim i ligjit, institucione efektive me përgjegjësi fiskale dhe financiare si nevojë thelbësore për ekonomi të fuqishme të tregut të lirë

### 1.1 Takim mes Kryesisë së OEMVP dhe Kryetarit të Kuvendit z.Afrim Gashi: Në fokus korniza ligjore e qëndrueshme, përfshirja aktive e biznesit dhe dialogu institucional

**11.08.2025, Shkup** - Ushtruesi i detyrës së Kryetarit të Odës Ekonomike të Maqedonisë Veri-Perëndimore, z. Nuhi Aliu, së bashku me Drejtorin Ekzekutiv, z. Durim Zeqiri, Nënkryetarin, z. Shpresim Tairi, dhe anëtarin e Këshillit Drejtues, z. Reshat Musliu realizuan takim me Kryetarin e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, z. Afrim Gashi.

Takimi kishte për qëllim forcimin e bashkëpunimit institucional mes Kuvendit dhe komunitetit të biznesit, si dhe prezantimin zyrtar të U.D. Kryetarit të ri të OEMVP-së.



### 1.2 Takim i OEMVP me Komisionin për mbrojtjen e konkurrencës - Forcimi i mekanizmave për konkurrencë të ndershme

**12.08.2025, Shkup** - Një delegacion i lartë i Odës Ekonomike të Maqedonisë Veri-Perëndimore, i udhëhequr nga ushtruesi i detyrës së Kryetarit, z. Nuhi Aliu, së bashku me Drejtorin Ekzekutiv, z. Zekiri, Kryetarin e kuvendit, Kryetarin e nderit dhe anëtarin e Këshillit Drejtues, zhvilloi një takim pune me Kryetaren e Komisionit për mbrojtjen e konkurrencës, znj. Malinka Siljanovska Nikoliq, dhe anëtarë të këtij institucioni – organ kyç për ruajtjen e konkurrencës së ndershme dhe funksionimin e ekonomisë së tregut, me kompetenca të gjera ligjore në parandalimin e praktikave monopoliste.



---

### 1.3 OEMVP në takim me Bankën Popullore - Guvernatori mirëpret propozimet e OEMVP-së për përmirësimin e kushteve financiare

---

**13.08.2025, Shkup** - Delegacioni i Odës Ekonomike të Maqedonisë Veri-Perëndimore, i përbërë nga U.D. Kryetari Nuhi Aliu, Drejtori Ekzekutiv Durim Zekiri, Kryetari i Nderit Xhemail Dauti, Kryetari i Kuvendit Nazmi Ejupi dhe anëtarë të Këshillit Drejtues Agron Mustafi, zhvilloi një takim zyrtar me Guvernatorin e Bankës Popullore të RMV-së, Dr. Trajko Slaveski.



Në pritje morën pjesë edhe zëvendës-guvernatorët Dr. Fadil Bajrami dhe znj. Emilija Nacevska, si dhe këshilltarja e Guvernatorit.

## 2. Fuqi punëtore të mjaftueshme dhe të kualifikuar me një ekonomi diverze dhe zhvillimore që parandalon emigrimin

### 2.1 Një falënderim për më shumë se 100 kompani nga Struga dhe rrethina për praninë në këtë ngjarje!

**05.07.2025, Strugë** - Ministria e Ekonomisë dhe Punës, në bashkëpunim me Agjencinë për Punësim, prezantoi sot Planin Operativ për Punësim, në ngjarjen e organizuar te Ęmbla Hotel & Spa në Strugë.

Plani përfshin masa konkrete dhe mbështetje direkte për kompanitë vendore, me synim rritjen e punësimit dhe fuqizimin e sektorit privat në vend.



Në kuadër të ngjarjes, u mbajt edhe një panel diskutimi, ku folës ishin: ministri i Ekonomisë dhe Punës, Besar Durmishi, kryetari i OEMVP-së, Mendi Qyra, drejtori i Agjencisë për Punësim, Selatin Beluli dhe zëdhënësjja e Qeverisë së RMV-së, Venera Latifi Azizi.

## 4. Odë me kredibilitet dhe përfshirje lokale dhe rajonale, lidere në mbrojtje të interesave afariste

### 4.1 OEMVP mirëpret Ambasadoren e Japonisë në Shkup, Shkëlqesinë e Saj znj.Kawahara Setsuko – u diskutua thellimi i bashkëpunimit ekonomik me Japoninë

**01.07.2025, Shkup** – Oda Ekonomike e Maqedonisë Veri-Perëndimore realizoi takim me Ambasadoren e Japonisë në Shkup, Shkëlqesia e Saj znj. Setsuko Kawahara, në kuadër të përpjekjeve të vazhdueshme për thellimin e bashkëpunimit ekonomik ndërkombëtar dhe krijimin e mundësive të reja për zhvillim.

Ambasadorja Kawahara u mirëprit nga Kryetari i OEMVP-së, z. Mendi Qyra, Drejtori Ekzekutiv z. Durim Zekiri, Nënkryetari z. Shpresim Tairi, si dhe anëtarët e Këshillit Drejtues, z. Menderes Kuçi dhe znj. Qanije Selimi.



### 4.2 OEMVP zhvillon takim me kryesinë e Aleanca Kosovare e Bizneseve

**01.07.2025, Shkup** – Kryetari i OEMVP-së, z. Mendi Qyra, së bashku me Kryetarin e Kuvendit të OEMVP-së, z. Ejupi, Drejtorin Ekzekutiv, z. Durim Zeqiri, Nënkryetarin, z. Shpresim Tairi, si dhe anëtarët e Këshillit Drejtues, z. Kuçi dhe znj. Selimi, pritën në takim Kryetarin e Aleancës Kosovare të Bizneseve, z. Agim Shahini, dhe përfaqësuesit e bordit drejtues.

Takimi u fokusua në diskutime rreth heqjes së reciprocitetit për blerjen e patundshmërive mes vendeve, kështu duke shqyrtuar mundësitë për forcimin e bashkëpunimit ekonomik ndërmjet dy vendeve, me theks të veçantë në përmirësimin e klimës afariste.



---

### 4.3 Hapja solemne e Ëmbla Hotel & Spa në zemër të Strugës – një tjetër sukses i kompanisë Trim&Lum

---

**11.07.2025, Strugë** - Në një ceremoni të veçantë, në orën 19:30, u bë prerja e shiritit të Hotelit “ËMBLA”, një investim vizionar i z. Mendi Qyra dhe kompanisë së tij, që i jep Strugës jo vetëm një hapësirë të re akomodimi, por një simbol të standardeve të reja në turizëm dhe mikpritje.

Ky hotel modern, i ndërtuar me ndjeshmëri për traditën dhe karakterin lokal, restorant me kuzhinë rreth 1000 metra katrorë dhe me 90 dhoma, do të punësojë mbi 100 persona, me çka edhe ndjeshëm godet papunësinë në atë qytet dhe jo vetëm.



---

### 4.4 Kryetari Mendi Qyra deponon dorëheqjen, emërohet Ushtruesi i Detyrës së Kryetarit z. Nuhi Aliu. Mbahet mbledhja e IV-të e Këshillit Drejtues të OEMVP!

---

**25.07.2025, Shkup** –Sot, në ambientet e Odës Ekonomike të Maqedonisë Veri-Perëndimore u mbajt mbledhja e IV-të e Këshillit Drejtues, e thirrur nga Kryetari z. Mendi Qyra, me prani të Drejtorit Ekzekutiv z. Durim Zekiri si dhe përfaqësues të Këshillit Mbikëqyrës.

Në këtë mbledhje Kryetari i OEMVP-së z. Mendi Qyra, në pikën e fundit të rendit të ditës, deponoi dorëheqjen e tij nga posti i Kryetarit të OEMVP-së.



---

#### 4.5 OEMVP takohet me Odën e Industrisë së Konja-s. Diskutohen mundësi bashkëpunimi për kompanitë anëtare të të dyja palëve

---

**30.07.2025, Shkup** – Drejtori Ekzekutiv i Odës Ekonomike të Maqedonisë Veri-Perëndimore, Durim Zeqiri, mirëpriti në takim përfaqësues të Odës së Industrisë së Konja-s, gjegjësisht Sekretarin e Përgjithshëm, z. Fatih Bayraktar dhe përfaqësues të tjerë, me qëllim të eksplorimit të mundësive të bashkëpunimit mes kompanive anëtare të OEMVP dhe të OIK.



Në takim u diskutua për pjesëmarrjen e përfaqësuesve të OEMVP-së në panairë në Turqi, kryesisht në panairin ku takohen furnitorët dhe blerësit e industrisë së mbrojtjes, i cili për herë të 8-të këtë vit organizohet në Konja të Turqisë.

---

#### 4.6 Takim me Ministrin e Bujqësisë z. Tripunovski - OEMVP apelon për strategji afatgjatë në mbrojtjen e prodhimeve vendore

---

**14.08.2025, Shkup** - Sot, në selinë e Odës Ekonomike të Maqedonisë Veri-Perëndimore u zhvillua një takim ndërmjet Ministrin të Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave, z. Cvetan Tripunovski, dhe përfaqësuesve të OEMVP-së. Në takim u pritën nga U.D. Kryetari z. Nuh Aliu, Drejtori Ekzekutiv z. Durim Zeqiri, si dhe anëtarë të Grupacionit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural pranë OEMVP, të kryesuar nga koordinatori z. Arben Halili.



Qëllimi i takimit ishte prezantimi i fushatës së Ministrisë “Më e mira e Maqedonisë: Tradita jonë, krenaria jonë”, e cila synon forcimin e prodhimit bujqësor vendor dhe ngritjen e vetëdijes për cilësinë e produkteve bujqësore të vendit. OEMVP dhe kompanitë anëtare të sektorit e përshëndetën këtë nismë, duke shprehur gatishmërinë për ta mbështetur, përfshirë edhe vendosjen e logos së fushatës në produktet e tyre. Në të njëjtën kohë, ata apeluan që kjo të mos mbetet një iniciativë e përkohshme, por të ketë vazhdimësi afatgjatë, duke pasur parasysh rëndësinë e këtij sektori për ekonominë kombëtare.

#### 4.7 OEMVP mirëpret delegacion biznesi nga Turqia për mundësi të reja bashkëpunimi

**20.08.2025, Shkup** – Në ambientet e Odës Ekonomike të Maqedonisë Veri-Perëndimore u zhvillua një takim biznesi me delegacion nga Turqia, i udhëhequr nga z. Rifat Sait. Delegacioni u mirëprit nga U.D. Kryetari i OEMVP-së, z. Nuhi Aliu, Drejtori Ekzekutiv, z. Durim Zekiri, si dhe nga kompani anëtare të Odës.

Anëtarët e OEMVP-së patën rastin të prezantojnë veprimtarinë e tyre, duke hapur rrugën për mundësi konkrete bashkëpunimi dypalësh. Në fjalën e tij, z. Aliu theksoi se OEMVP është adresa më e duhur ku çdo investitor potencial mund të gjejë mbështetje, informacione të besueshme për tregun dhe lidhje direkte me kompani serioze për partneritet.



#### 4.8 Takim mes U.D Kryetarit të OEMVP, z. Nuhi Aliu, dhe Kryetarit të OEMV, z. Branko Azeski

**25.08.2025, Shkup** - U.D. Kryetari i Odës Ekonomike të Maqedonisë Veri-Perëndimore, z. Nuhi Aliu, realizoi takim me Kryetarin e Odës Ekonomike të Maqedonisë së Veriut, z. Branko Azeski. Takimi u karakterizua nga një atmosferë bashkëpunuese dhe u fokusua në forcimin e raporteve institucionale mes dy odave, të cilat prej shumë vitesh luajnë rol kyç në përfaqësimin e interesave të komunitetit të biznesit në vend.

Takimi ofroi gjithashtu mundësinë për shkëmbimin e ideve dhe ekspertizës ndërmjet dy institucioneve, me fokus në fillimin e iniciativave të reja dhe avancimin e atyre ekzistuese me qëllim krijimin e kushteve më të mira për zhvillimin e sektorit privat.



---

#### 4.9 Mbahet mbledhja e V-të e Këshillit Drejtues të OEMVP. Diskutohen prioritetet për zhvillim ekonomik lokal.

---

**02.09.2025, Shkup** - Oda Ekonomike e Maqedonisë Veri-Perëndimore realizoi mbledhjen e V-të të Këshillit Drejtues, të udhëhequr nga ushtruesi i detyrës së Kryetarit, z. Nuhi Aliu me prani të anëtarëve të KD, Kryetarit të Kuvendit, Kryetarit të Nderit si dhe Drejtorin Ekzekutiv z. Durim Zekiri.

Gjatë mbledhjes u shqyrtuan dhe u diskutuan një sërë çështjesh me rëndësi sa i përket realizimit të plotë të aktiviteteve të parapara në periudhën që vijon, e veçanërisht në kuartalin e fundit të vitit.



---

#### 4.10 OEMVP ndërmjetëson bashkëpunim të ri mes kompanive vendore dhe bizneseve turke të sektorit të ndërtimitarisë

---

**11.09.2025, Shkup** – Drejtori ekzekutiv i Odës Ekonomike të Maqedonisë Veri-Perëndimore priti në takim delegacion nga Turqia, të përbërë nga përfaqësues të Drejtorisë së Përgjithshme të Eksporteve pranë Ministrisë së Tregtisë së Turqisë, anëtarë të Bordit të Shoqatës së Eksportuesve të Metaleve, si dhe përfaqësues të Ambasadës së Turqisë në RMV.

Në takim u diskutua për mundësitë e zgjerimit të bashkëpunimit ekonomik dhe për organizimin e ngjarjes B2B, të koordinuar nga Ministria e Tregtisë së Turqisë dhe Shoqata e Eksportuesve të Metaleve Ferroze dhe Jo-Ferroze të Stambollit (İDDMİB), ku OEMVP mori pjesë me kompanitë e anëtare.



#### 4.11 Neho Ice Cream, anëtar i më i ri i Odës Ekonomike të Maqedonisë Veri-Perëndimore

**16.09.2025, Shkup** - Në hapësirat e OEMVP, U.D. Kryetar i OEMVP-së, z. Nuhi Aliu, Drejtori Ekzekutiv, z. Durim Zeqiri, dhe Menaxherja Operative, Miranda Ajdini, mirëpritën në takim Drejtorin komercial z. Avni Saliu dhe Drejtorin e eksportit dhe zhvillim të tregut, z. Sokol Zekiri nga kompania Neho Ice Cream. Qëllimi i këtij takimi ishte njohja nga afër me historinë, vizionin dhe planet zhvillimore të kompanisë, si dhe mbështetja e OEMVP drejt sektorit të biznesit.



Neho Ice Cream është një histori suksesi që filloi si biznes familjar dhe sot është shndërruar në një kompani moderne e cila ofron mbi 80 produkte të ndryshme akulloresh. Pasioni për cilësinë dhe inovacionin e ka bërë këtë markë të jetë një nga më të njohurat në tregun vendor dhe ndërkombëtar. Në vitin 2024, mbi 60% e prodhimit të Neho-s eksportohet në tregje rajonale dhe evropiane, duke e bërë këtë kompani një ambasador të vërtetë të shijes dhe cilësisë vendore në tregjet jashtë kufijve.

#### 4.12 OEMVP realizon takim konsultativ në Ministrinë e Energjisë, minierave dhe lëndëve të para. Diskutohen zhvillimet e sektorit energjetik dhe problemet e biznesit me të njëjtën

**15.09.2025, Shkup** – Kryetari i Grupacionit të Energjetikës pranë OEMVP z. Sami Morina së bashku me Drejtorin Ekzekutiv të OEMVP z. Durim Zeqiri u takuan me udhëheqësen e sektorit të energjetikës znj. Stardelova dhe udhëheqësen e sektorit të burimeve të energjisë së rinovueshme znj. Daskalova pranë Ministrisë së Energjisë, minierave dhe lëndëve të para.

U diskutuan çështje me rëndësi që kanë të bëjnë me biznesin dhe problematikat e tyre me energjinë, ligji i ri për energjetikë si dhe u diskutua për rregulloret të cilat duhet të sjellën me qëllim të funksionalizimit të plotë të ligjit.



#### 4.13 OEMVP zhvillon takim informativ me Ministrinë e mjedisit jetësor rreth Projektit rajonal për menaxhimin e mbeturinave në Pollog

**Shkup, 16.09.2025** – Në hapësirat e Odës Ekonomike të Maqedonisë Veri-Perëndimore, udhëheqësia e Odës dhe përfaqësues nga Grupacioni i ndërtimtarisë, urbanizmit, mjedisit dhe energjetikës mirëpritën në takim pune përfaqësues nga Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor.



Në takim u prezantua Projekti Rajonal për menaxhimin e mbeturinave në rajonin e Pollogut, duke e bërë iniciativën e parë në nivel shtetëror për menaxhimin e qëndrueshëm të mbetjeve dhe një hap të rëndësishëm drejt përputhjes me standardet e BE-së. Projekti, që do të realizohet në Tetovë – Falishte, parashikon ndërtimin e një deponie rajonale sanitare sipas standardeve evropiane.

#### 4.14 Takim pune me Odën Ekonomike të Dubait, OEMVP prezanton mundësitë e bashkëpunimit në kuadër të anëtarësisë së saj

**22.09.2025, Shkup** - Drejtori ekzekutiv i OEMVP, z. Durim Zeqiri, Kryetari i Grupacionit për bujqësi dhe zhvillim rural, z. Arben Halili, znj. Egzona Aliu si përfaqësuese e Grupacionit për Turizëm dhe Hotelieri me kompaninë Hotel Actor dhe menaxherja operative Miranda Ajdini morën pjesë në takimin e punës të organizuar nga Qeveria e RMV-së, me rastin e vizitës së delegacionit të Odës Ekonomike të Dubait. Qëllimi i takimit ishte të eksploroheh mundësi për bashkëpunim me kompanitë vendore si dhe potencialin që vendi jonë ka për investime.



Takimi u hap me një fjalë rasti nga Kryeministri i RMV, z. Hristijan Mickoski duke theksuar prioritetin e Qeverisë për stabilitet ekonomik të vendit dhe tërheqjen e investimeve të huaja direkte, por edhe mbështetjen e investitorëve vendas.

---

## **Informatori ekonomik ECONOMICUS**

---

Gjatë kuartalit të tretë të vitit 2025 janë publikuar 3 edicione të informatorit ekonomik ECONOMICUS. Temat të cilat janë prezantuar në këtë informator ekonomik janë:

- **Economicus nr.6** – Indekset e numrit të të punësuarve në Industri, maj 2025
- **Economicus nr.7** - Indeksi i qarkullimit në sektorin e Tregtisë, Qershor 2025, të dhënat paraprake
- **Economicus nr.8** - Transporti i udhëtarëve dhe mallrave, tremujori i dytë 2025

---

## Biznes Informatori DOBIA

---

Gjatë kuartalit të tretë të vitit 2025 anëtarët e OEMVP kanë patur mundësi të njoftohen nëpërmjet informatorit ekonomik DOBIA për thirrje publike në lidhje me grante dhe mundësi për financim. Gjatë kësaj periudhe përmes e-mailit janë dërguar tek anëtarët 6 edicione të informatorit, ndërsa njoftimi për dërgimin e të njëjtit është shpërndarë edhe në rrjetet sociale të Odës.

Thirrjet të cilat janë mbuluar në këtë edicion të informatorit janë:

- **Dobia nr.11** – Thirrje publike drejtuar punëdhënësve për kyçje në masën aktive 5 – Praktikë.
- **Dobia nr.12** – Thirrje publike për kompensimin e një pjese të shpenzimeve për laboratorë.
- **Dobia nr.13** – Thirrje publike për mbështetje të zhvillimit, mirëmbajtjes dhe zbatimit të praktikave të pranueshme sociale të subjekteve afariste në Republikën e Maqedonisë së Veriut
- **Dobia nr.14** – Thirrje publike për ndërmarrjet e sektorit privat që janë të gatshme të nxisin zhvillimin e tyre afarist duke krijuar vende të reja pune përmes investimeve të gjelbra.
- **Dobia nr.15** – Thirrje publike për hapje të vendeve të reja të punës në subjekte afariste (ndërmarrje mikro, të vogla dhe të mesme), të cilat duan ta zgjerojnë dhe zhvillojnë biznesin e tyre nëpërmjet shfrytëzimit të mjeteve kreditore.
- **Dobia nr.16** – Thirrje publike për aplikim me propozime projektsh për mbështetjen e ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (NVM) në kuadër të Prioritetit 3 - Zhvillimi i integruar i rajonit kufitar me objektivin specifik (SO) 1: "Rritja e konkurrencës së ekonomisë lokale dhe përmirësimi i mjedisit të biznesit


## 5. Zvogëlimi i ekonomisë gri (joformale), minimizimi i korrupsionit dhe konkurrencës jo lojale si parakusht i konkurrueshmërisë së shëndoshë ekonomike

### 5.1 REAGIM

**20.08.2025** – Kushtin nga masa e Qeverisë për dhënien e vauçerëve prej 250€ për studentët për blerje të laptopëve apo tabletëve, që kompanitë të kenë minimum dy ekspozitura në territorin e vendit, OEMVP e vlerëson si kriter diskriminues.

Ky kufizim i përjashton shumicën e bizneseve të vogla dhe të mesme, të cilat në shumicën e rasteve operojnë vetëm me një ekspoziturë, por megjithatë ofrojnë shërbime cilësore dhe profesionale dhe krijojnë konkurrencë jo të barabartë, duke favorizuar vetëm operatorët më të mëdhenj.

OEMVP u bënë thirrje institucioneve përkatëse që të rishikojnë kushtet e thirrjes publike dhe të mundësojnë qasje të barabartë për të gjitha kompanitë në mënyrë që të shmangët krijimi i konkurrencës jolojale dhe të sigurohet trajtim i drejtë për të gjithë operatorët ekonomikë.



## 6. Marrëdhëniet me publikun

- **01.07.2025** - Drejtori Ekzekutiv i OEMVP-së z. Durim Zeqiri, për Portalb u shpreh se "Vetëpunësimi është zgjidhje jo vetëm për të rinjtë, por edhe për sfidat ekonomike

<https://www.facebook.com/oemvp.org/posts/pfbid0gHGtuiWv1z77gxMifN86VtLJDDBvkPG5u55qRw4NLfn6Hi8PKNqaFEkRJPxwMSfal>

- **11.07.2025** - (Видео) Трилинг: Македонија и ЕУ – Внатрешните битки зад европската цел

<https://triling.mk/%d0%b2%d0%b8%d0%b4%d0%b5%d0%be-%d1%82%d1%80%d0%b8%d0%bb%d0%b8%d0%bd%d0%b3-%d0%bc%d0%b0%d0%ba%d0%b5%d0%b4%d0%be%d0%bd%d0%b8%d1%98%d0%b0-%d0%b8-%d0%b5%d1%83-%d0%b2%d0%bd%d0%b0%d1%82%d1%80%d0%b5/>

- **23.07.2025** - Drejtori Ekzekutiv i OEMVP-së, z. Durim Zeqiri, në deklaratën e dhënë për TVM 2 lidhur me masat e reja të lajmëruara nga Qeveria për rritjen e çmimeve

<https://www.facebook.com/oemvp.org/posts/pfbid06ggLoYc7qkkmYMWjwKxt3ax5XBcS7Srfck1Ej73mhsPRLo4XQa9wHC2Gjp9x2UrFl>

- **02.08.2025** - Durim Zeqiri: Kriteret e qeverisë për vauçerët e studentëve duhet të rishqyrtohen, diskriminohen bizneset e vogla dhe të mesme

[https://portalb.mk/durim-zeqiri-kriteret-e-qeverise-per-vauceret-e-studenteve-duhet-te-rishqyrtohen-diskriminohen-bizneset-e-vogla-dhe-te-mesme/?fbclid=IwY2xjawOaiflleHRuA2FlbQIxMQBzcnRjBmFwcF9pZBAyMjlwMzcxNzg4MjAwODkyAAEev-iLLsvl2iioprz7VOugwon44RXjbmMmmJWkjC6flA6aLywy8PiNI-QiGylw\\_aem\\_W9Qbf61nzcHhnFad9aLsKg](https://portalb.mk/durim-zeqiri-kriteret-e-qeverise-per-vauceret-e-studenteve-duhet-te-rishqyrtohen-diskriminohen-bizneset-e-vogla-dhe-te-mesme/?fbclid=IwY2xjawOaiflleHRuA2FlbQIxMQBzcnRjBmFwcF9pZBAyMjlwMzcxNzg4MjAwODkyAAEev-iLLsvl2iioprz7VOugwon44RXjbmMmmJWkjC6flA6aLywy8PiNI-QiGylw_aem_W9Qbf61nzcHhnFad9aLsKg)

- **10.09.2025** - Drejtori Ekzekutiv z. Durim Zeqiri për Radio Evropa e Lirë theksoi se kjo thirrje publike nxit konkurrencë jo-lojale.

[https://www.slobodnaevropa.mk/amp/studenti-vaucer-kompjuter-/33521585.html?fbclid=IwY2xjawOainhleHRuA2FlbQIxMQBzcnRjBmFwcF9pZBAyMjlwMzcxNzg4MjAwODkyAAEetXvcuhnry0bwF2TkCC0X8fRPz-na9jDEimKnzO0P5Gyfp\\_aZHanrf1RuS4\\_aem\\_4x0I-u6ijJZQa1QwbRPCvw](https://www.slobodnaevropa.mk/amp/studenti-vaucer-kompjuter-/33521585.html?fbclid=IwY2xjawOainhleHRuA2FlbQIxMQBzcnRjBmFwcF9pZBAyMjlwMzcxNzg4MjAwODkyAAEetXvcuhnry0bwF2TkCC0X8fRPz-na9jDEimKnzO0P5Gyfp_aZHanrf1RuS4_aem_4x0I-u6ijJZQa1QwbRPCvw)

## 7. Komunikimi me anëtarët

Gjatë tremujorit të tretë të vitit 2025 Desku i shërbimeve ka realizuar mbi 1477 kontakte me kompani në forma të ndryshme (thirrje telefonike dhe e-mail) dhe njëkohësisht Desku i shërbimeve është kontaktuar rreth 800 herë.

Gjithashtu gjatë tremujorit të parë, në OEMVP janë anëtarësuar gjithsej 11 kompani të reja.

## 8. OEMVP në media

Gjatë periudhës Korrik – Shtator 2025, përfaqësues të OEMVP kanë qenë prezent në media 8 herë, ndër të cilat:

- në emisione – 5;
- deklarata në TV – 2;
- deklarata në media të shtypura – 1

Gjithashtu, gjatë periudhës së njëjtë OEMVP është cituar mbi 200 herë.


## 9. OEMVP në rrjetet sociale

OEMVP, me përfundimin e kuartalit të tretë të vitit 2025, në rrjetin social FACEBOOK numëron gjithsej:

- 8,769 ndjekës;

Krahasuar me vitin paraprak janar - dhjetor, këtë vit deri në fund të muajit shtator kemi rritje të ndjekësve të profilit për 3.31%%.

Ndërkaq, OEMVP është aktive edhe në rrjetet tjera sociale dhe atë INSTAGRAM ku gjithsej numëron 614 ndjekës dhe LinkedIn me gjithsej 371 ndjekës.



## Shërbimet e OEMVP

Oda Ekonomike e Maqedonisë Veri-Perëndimore është një partner që ndihmon bizneset në rrugën e tyre drejt suksesit afarist përmes një game të gjerë shërbimesh.



**SHËRBIMET INFORMATIVE** – Anëtarët e OEMVP-së kanë mundësi të informohen nëpërmjet kanaleve të informimit në fushat e tyre të interesit siç janë: Informatori ekonomik **ECONOMICUS**, Biznes informatori **DOBIA**, Informatori Juridik **JURIS dhe JURIS ALARM**, **BULETINI I OEMVP-së, THIRRJE PËR TENDERË NDËRKOMBËTARË, PANAIRE RAJONALE DHE NDËRKOMBËTARE.**



**SHËRBIMET PROMOVUESE** – OEMVP nëpërmjet shërbimeve promovuese të saj, mbështet anëtarët e saj duke i promovuar të njëjtit, duke përfshirë këtu, kompanitë start-up, kompanitë të cilat kanë lancuar shërbim të ri, kompanitë që kanë oferta të reja promovuese, etj. Roli i odës është ti promovojë të njëjtit përmes: promovimit në **Rrjetet sociale**, shërbimit **“Anëtari për Anëtarin” (nëpërmjet e-mailit), Logo në web faqen e OEMVP, video në korridorin e OEMVP, materiale promovuese në sallën e takimeve të odës si dhe katalogu TOP 100™.**



**QENDRA E TRAJNIMEVE**- Qendra e trajnimeve të OEMVP-së është aktive për të ju shërbyer kompanive me trajnime të temave të ndryshme, duke përbushur nevojat e tyre për trajnim dhe përgatitje të kuadrove të tyre. Trajnimet kryhen në bazë të **Planit vjetor të OEMVP-së apo sipas kërkesave specifike të anëtarëve.**



**QENDRA PËR CILËSI DHE STANDARDE** - Oda Ekonomike e Maqedonisë Veri-Perëndimore përmes Qendrës së saj për cilësi dhe standarde, anëtarëve Ju ofron: **ISO Standarde, HASSP Standarde, Halal Standarde.**



**KONSULENCA DHE ANALIZA** – Ky shërbim përfshin: **Konsultime (ligjore dhe ekonomike), Analiza financiare sipas kërkesës, Shërbime patentimi, Shërbime të pronësisë intelektuale, Kërkesa drejtuar institucioneve.**



**SHËRBIMET E TJERA** - Çertifikata e Origjinës, Çertifikata e Origjinës-Elektronike, Lobim, Lobim sipas kërkesave individuale, Ftesë për panairë virtuale për ndërlidhje të bizneseve me regjionin, Shërbime administrative, B2B takime, Qasje deri te Grupacionet e Odës, Ftesë në ngjarjet e OEMVP-së (seminare, konferenca, samite), Vende të rezervuara në çdo ngjarje të OEMVP-së, Asistim për pjesëmarrje në panairë të ndryshme botërore, Përfaqësim i interesave të anëtarësisë para institucioneve shtetërore dhe ndërkombëtare, Drekë me kryeministrin/presidentin/ministrat, Iftari Tradicional, Vërtetim për anëtarësi.



**SHËRBIME TEKNIKE** – Hapësira të lira për anëtarët në zyrat e OEMVP-së për takime dhe biseda biznesore (deri 1 orë), Sallë për shfrytëzim njëditor dhe disaditor (deri 15 vende).



**KATALOGU TOP 100™** - Katalogu TOP 100™ i kompanive më të suksesshme në Maqedoninë e Veriut është një platformë rrjetëzimi dhe promovimi, ku promovohen bizneset e suksesshme, por gjithashtu krijohen mundësi të reja për bashkëpunime potenciale mes anëtarëve ekzistues dhe anëtarëve potencial. Ky katalog ofron një mundësi të shkëlqyeshme, për kompanitë që duan të prezantojnë produktet dhe shërbimet e tyre para një audience të gjerë, duke stimuluar vizibilitetin e tyre dhe forcimin e pozicionit në treg, dhe njëkohësisht duke i bërë kompanitë më konkurruese në tregun vendor dhe ndërkombëtar.